Njoftim për përqendrim me të cilin DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED, Indi, do të realizojë investim strategjik në AUTOBAHN TRUCKING CORPORATION PRIVATE LIMITED, Indi
(Lënda nr. 08-155/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 28.10.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftimi për përqendrim, me të cilin **DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED (Daimler India Commercial Vehicles Private Limited)**, me seli të regjistruar në SIPCOT Industrial Growth Centre, Oragadam, Mathur Post, Kundrathur Taluk, Distrikti Kancheepuram, Tamil Nadu 602118, Indi, do të realizojë investim strategjik në **AUTOBAHN TRUCKING CORPORATION PRIVATE LIMITED (Autobahn Trucking Corporation Private Limited)**, me seli në IX/9E, Nippon Towers, NH 47, H.M.T. Junction, Kalamassery P.O., Ernakulam, Kerala 683104, Indi.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED është prodhues dhe furnizues i automjeteve komerciale në Indi, me markën BharatBenz, e dedikuar për tregun vendor. DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED prodhon dhe shet kamionë dhe autobusë me kapacitet nga 10 deri në 55 tonë, autobusë turistikë dhe shasi për autobusë, ndërsa për tregjet e eksportit prodhon gjithashtu automjete të markave të Daimler Trucks – Mercedes-Benz dhe Freightliner, në përputhje me një standard global të cilësisë. Produktet dhe pjesët eksportohen në më shumë se 60 tregje në Afrikë, Azi, Amerikën Latine dhe Lindjen e Mesme. DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED është shoqëri në pronësi të plotë të Daimler Truck AG, e cila, nga ana e saj, është në pronësi të plotë të Daimler Truck Holding AG (shoqëri e pastër holding), me seli në Shtutgart, Gjermani. Daimler Truck AG është aktive në veprimtarinë e prodhimit të kamionëve dhe autobusëve dhe është e përqendruar në prodhimin dhe shitjen e tyre. Gama e produkteve të Daimler Truck AG përfshin kamionë të mesëm dhe të rëndë për transport në distanca të gjata, transport dhe shpërndarje të mallrave, transport për në kantieret e ndërtimit, si dhe automjete speciale që kryesisht përdoren për nevoja komunale.

Daimler Truck Holding AG / Daimler Truck AG nuk kontrollon asnjë shoqëri të varur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa produktet e saj shpërndahen nga distributori i pavarur, shoqëria MAK AUTOSTAR SHPKNJP Shkup.

DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk ushtron veprimtari në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të hyra nga blerës me vendndodhje në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

AUTOBAHN TRUCKING CORPORATION PRIVATE LIMITED është themeluar në vitin 2012 si distributor i autorizuar dhe qendër e autorizuar e servisit për kamionë dhe autobusë të markës BharatBenz, të prodhuar nga DAIMLER INDIA COMMERCIAL VEHICLES PRIVATE LIMITED. Që nga themelimi, AUTOBAHN TRUCKING CORPORATION PRIVATE LIMITED e ka zgjeruar dhe diversifikuar veprimtarinë e saj, ndërsa aktualisht operon në shtetet indiane Kerala, Maharashtra, Goa, Uttar Pradesh, Uttarakhand dhe Haryana.

AUTOBAHN TRUCKING CORPORATION PRIVATE LIMITED ka një shoqëri të varur, Autobahn Mobility Private Limited, e cila është distributor i autorizuar dhe qendër e autorizuar e servisit për automjete të udhëtarëve dhe automjete të vogla komerciale të markës Mahindra në shtetin indian Kerala.

AUTOBAHN TRUCKING CORPORATION PRIVATE LIMITED nuk ka shoqëri të varura, degë ose përfaqësi të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon asnjë të hyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

02.11.2026

Shkup